

Specifikime teknike

Projekti: Restaurim dhe konservim i plote në fasadat e objektit “Galeria e Arteve, ish bashkia e qytetit të Shkodrës”

1. Heqje dyer/dritare

Ky çmim jepet në lek/m² dhe përfshin heqjen në këtë rast nga murtaura të cdo lloj dritareje apo dere të specifikuar në projekt. Heqja e dyerve dhe e dritareve do të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos dëmtohet muratura dhe si pasojë nuk ka nevojë për suvatim apo retukim i shpatullave të dritareve.

2. F.V. Dritare druri kasë binar tek xham

Ky çmim jepet në lek/m² dhe përfshin vendosjen në objekt të dritareve, ku konfiguracioni dhe përmasat e së cilave merren nga dritaret e specifikuara në V.T, por që do të verifikohen edhe me përmasat nga dritaret e hequra. Dritaret do të ndërtohen në dru pishe të stazhionuar dhe të imprenjuar me antimol dhe vaj lini.

3. F.V. Dere e jashtme druri masiv me spesor 5cm, cilesi e I-re

Ky çmim jepet në lek/m² dhe përfshin vendosjen në objekt të dyerve të jashtme, ku konfiguracioni dhe përmasat e së cilave merren nga dyert e specifikuara në F.T, por që do të verifikohen edhe me përmasat nga dyert e hequra.

4. Pastrim i suvatimit dhe mbushjeve me llac në muret e objektit nga jashtë

Ky çmim jepet në lek/m² dhe përfshin pastrimin e suvatimit me mjetet perkatese si dhe mbushjen me llac në muret e objektit nga jashtë aty ku është e nevojshme. Të kihen kujdes dhe të pastrohet me pergjegjesi fasada e objektit në fjalë. Përsa i përket mbushjeve, të konsultohet me supervizorin në rast të problemeve që mund të dalin gjatë zbatimit.

5. Suva e zakonshme fasade mur tulle llaç gelqere 1:2 (fasada lindore)

Ky çmim jepet në lek/m². Fasada lindore do të suvatohet pasi për momentin është pa suva dhe në tulle. Suvatimi do të jetë me llaç gelqere 1:2.

6. Sherbetisje e bojatisje me gelqere

Objekti pasi të pastrohet dhe të mbushet në vendet e nevojshme me suvatim, do të nënshtrohet sherbetisjes dhe bojatisjes me gelqere. Ngjyra që do të përdoret, domosdoshmërisht do të aprovohet nga supervizori i cili do të miratojë ngjyrën duke u bazuar në ngjyrën aktuale të objektit si dhe në dokumentacionin arkivor që

disponohet per “Galerine e Arteve”.

7. F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar

Kangjellat metalike te dritareve do te çmontohen te gjitha. Zgara e re do te kete te njejtin konfiguracion dekorativ si e vjetra. Keto zgara do te vendosen ne te gjitha dritaret e katit perdhe. Persa i perket dyerve te drurit, gjate zbatimit te punimeve, te konsultohen te gjitha palet e interesuara dhe te japin nje zgjidhje nese kane nevojë per zgara hekuri dekorative dyert e drurit apo jo. Ky çmim jepet ne lek/m2.

Punoi: Elson Laqja
Oltion Çuni
Fatjon Mlloja
Sabrina Kuçi

Miratohet: Petrit Bilali

Drejtor: Helidon Sokoli

